



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 718 Akti

Nr. 475 Vendimi
Tiranë, më 15.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 15.11.2021, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Shyqyri Durro**, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Shyqyri Durro, gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Shyqyri Durro do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioneri Olsi Komici.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP), si dhe filloi procedura e hetimit administrativ nga Komisioni.

4. Subjekti i rivlerësimit Shyqyri Durro, me kërkesën e datës 4.10.2021, drejtuar KLP-së, ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension pleqërie¹. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar kërkesën e tij në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Në vijim, Komisioni administroi shkresën² e KLP-së, bashkëlidhur me vendimin nr. ***, datë 25.10.2021, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, për subjektin Shyqyri Durro, ku është vendosur:

- a. *deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit për z. Shyqyri Durro, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë;*
- b. *dorëheqja jep efekt në datën 4.11.2021;*
- c. *të njoftohen për këtë vendim z. Shyqyri Durro, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;*
- d. *ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KLP-së.*

6. Komisioni administroi përgjigjen e Gjykatës Administrative të Apelit³, e cila konfirmon se deri në datën 10.11.2021, z. Shyqyri Durro, nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 25.10.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

7. Gjithashtu KLP-ja, me e-mail-in e datës 11.11.2021, në përgjigje të kërkesës së Komisionit me nr. *** prot., datë 9.11.2021, konfirmon se ndaj vendimit nr. ***, datë 25.10.2021, të KLP-së, nuk është bërë ankim nga subjekti Shyqyri Durro.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

8. Kolegji i Posaçëm Apelit, në lidhje me praktikën e gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në faza të ndryshme të tij, po kështu dhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj: (i) Presidenti i Republikës; (ii) Këshilli i Lartë Gjyqësor; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

¹Subjekti i rivlerësimit Shyqyri Durro është i datëlindjes 3.11.1954 dhe në datën 3.11.2021 mbush moshën e pensionit 67 vjeç.

²Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.10.2014.

³Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2021, e Gjykatës Administrative të Apelit.

9. Nga ana e KLP-së, bazuar në kërkesën për dorëheqje të bërë nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 25.10.2021, është vendosur deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për z. Shyqyri Durro, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit. Për këtë vendim, krahas Komisionit, është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit Shyqyri Durro.

10. Konfirmohet vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi z. Shyqyri Durro ka paraqitur dorëheqjen para KLP-së dhe pasi ky këshill ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit, subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi.

11. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe moscenimin e të drejtës së subjektit për t'u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në rrugë elektronike në datën 29.10.2021, ftoi në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit Shyqyri Durro, duke i kërkuar të shprehet lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit.

12. Subjekti i rivlerësimit Shyqyri Durro, në datën 1.11.2021, nëpërmjet postës elektronike ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën dëgjimore, pasi më 4.11.2021 mbush moshën për pension dhe kërkon mbarimin e statusit të magjistratit.

13. Ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në germen "c", të pikës 1, të nenit 64, ka përcaktuar mbarimin e statusit të magjistratit, kur ai mbush moshën e pensionit, ndërsa neni 65 i këtij ligji ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes⁴.

14. Trupi gjykues çmon se objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit apo qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur, referuar nenit 95 të Kodit të Procedurës Administrative, "Pamundësia në objekt apo qëllim", i cili specifikon: "*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*".

15. Sa më sipër, në referim të gremës "b", të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative, si edhe në konsideratë të faktit se subjekti i rivlerësimit u njoftua për zhvillimin e seancës dëgjimore, deklaroi mospjesëmarrjen e tij dhe konfirmoi kërkesën për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se procedura administrative për këtë subjekt duhet të mbyllet pa qenë e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore, pasi subjekti ka paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative.

16. Në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e

⁴ 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinë me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në germën “c”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Shyqyri Durro, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 15.11.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Valbona Sanxhaktari
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj